

Porosit e Muajit të

RAMAZANIT

TEUBEJA NË RAMAZAN

Vëllezer Musliman !

Gjëja më e keqe që ka mundësi ta godas njeriun është dëshprimi dhe humbja e shpresës në faljen dhe mëshirën e Allahut.

Nuk ka dyshim se Allahu ia pranon pendimin dhe ua falë mëkatet e veçanërisht në muajin e bekuar të Ramazanit. Andaj Ramazani është muaj i faljes, dhe njeriu le t'i kthehet Allahut sinqerisht me pendim në këtë muaj të faljes.

Allahu i Madhëruar i thërret robërit e Tij për pendim, duke thënë:

Thot Allahu Subhanehu we te A'la

﴿قُلْ يَاعِبَادِيَ الَّذِينَ أَسْرَفُوا عَلَىٰ أَنفُسِهِمْ لَا تَقْنَطُوا مِن رَّحْمَةِ

اللَّهِ إِنَّ اللَّهَ يَغْفِرُ الذُّنُوبَ جَمِيعًا إِنَّهُ هُوَ الْغَفُورُ الرَّحِيمُ﴾


Thuaj: "O robërit e mi, që i keni bërë keq vetvetes, mos ehumbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i falë të gjitha mëkatet. Ai, me të vërtetë, është falës dhe përdëllimtar." (Zumer: 53).

Po ashtu thot:

أَفَلَا يَتُوبُونَ إِلَى اللَّهِ وَيَسْتَغْفِرُونََهُ، وَاللَّهُ غَفُورٌ
رَحِيمٌ

“E pse të mos pendohen dhe të kërkojnë te Allahu falje, kur Allahu dihet se falë shumë, është mëshirues?”. (El-Maide: 74).

Ebu Hurejre radijAllahu anhu tregon se Pejgamberi sal-Allahu alejhi ve sel-lem duke hipur në minber tha: “Amin, amin, amin. I thanë: o i Dërguar i Allahut duke hypur në minber të dëgjuam duke thënë: amin, amin, amin. Tha: “Më erdhi Xhibrili [alejhis-selam] e më tha: cili e takon Ramazanin e nuk i falen mëkatet e largoftë Allahu nga Mëshira e Tij, thuaj amin, e unë thash: amin”. (Ahmedi, sahih).

Andaj vëllezer të përulur, e të penduar, duke qarë e të lutemi : O Zot i gjithësisë, unë u pendova më fal Amin !!!

Vëllazer të dashur!

Nëse nuk të falen mëkatet në këtë muaj, nëse në këtë muaj nuk të lotojnë sytë, nëse zemra jote para Zotit tënd nuk përulet në këtë muaj, vallë kur do të ndodh kjo gjë?!

Ja po të ofroj myzhde nga Zoti dhe Pejgamberi yt.

Allahu [subhanehu ve teala] thotë:

إِلَّا مَنْ تَابَ وَآمَنَ وَعَمِلَ عَمَلًا صَالِحًا فَأُولَٰئِكَ يُبَدِّلُ اللَّهُ
سَيِّئَاتِهِمْ حَسَنَاتٍ ۖ وَكَانَ اللَّهُ غَفُورًا رَحِيمًا ﴿٧٠﴾

"Përveç atij që është penduar dhe ka bërë vepër të mirë, të tillëve Allahu të këqijat ua shndërron në të mira. Allahu është mëshirues, ndaj Ai falë shumë". (El-Furkan: 70).

Pra, vëlla i dashur pendohu, nëse i dëshiron këto të mira. Nëse dëshiron që mëkatet të shndërrohen në vepra të mira.

Dëgjo se çka thotë Pejgamberi [sal-Allahu alejhi ve sel-lem]:

"Allahu më shumë gëzohet me pendimin e robit të Tij se sa njeriu që gjendet në shkretëtirë, të cilit i ka humbur deveja, në të cilën e ka pasur ushqimin e tij dhe e gjerat e tija". (Buhariu dhe Muslimi).

Pejgamberi [sal-Allahu alejhi ve sel-lem] thotë se Allahu ka thënë:

"O biri i Ademit! Nëse më lutesh dhe më shpreson, ti fali mëkatet që i ke bërë dhe nuk më intereson asgjë më tepër. Biri i Ademit, nëse mëkatet tuaja arrin kupën e qiellit, e pastaj kërkon falje, ti fali mëkatet dhe nuk më intereson asgjë". (Buhariu dhe Muslimi).

Po ashtu thotë:

“O robërit e Mi. ju bëni mëkate gjatë natës dhe gjatë ditës, kurse unë ua fali të gjitha mëkatet, andaj kërkoni falje, që tua fali”.

“Allahu e shtrin Dorën gjatë natës që të pendohet ai që ka bërë gabime gjatë ditës dhe e shtrinë Dorën gjatë ditës që të pendohet ai që ka bërë mëkate gjatë natës. Kështu vazhdon deri sa të del dielli nga perëndimi i tij”. (Muslimi).

Kur e pa Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] një grua duke e kërkuar fëmijën e saj në mesin e njerëzve të zërë rob, dhe kur e pa e përqafoi dhe e shtrëngoi për gjoksi tha: “A mendoni se kjo mundet ta hedh fëmijën e saj në zjarr? Thanë: jo. Tha: “Allahu është edhe më i Mëshirshëm se kjo grua ndaj fëmijës së sajë”.


A nuk është e madhe kjo bujari që të pendohemi!

I lartësuar qoftë Allahu sa i mëshirshëm, sa i butë dhe sa Bujar që është!

Dije se pendimi nuk është i veçantë vetëm për këtë muaj, por vazhdon edhe për muajt tjerë. Mirëpo ndoshta në këtë muaj të bekuar është lindja jote e re.


Njeriu mund të lind dy herë: atë ditë kur të del nga errësira e barkut të nënës dhe atë ditë që del nga errësira e mëkateve në dritën e adhurimeve.

Nëse nuk Pendohemi vëllezer thot Allahu subhanehu we te A'la



"E ata që nuk pendohen, janë mizorë. (Huxhurat, 11)

Andaj vëllezer Allahu subhanehu we te A'la na fton dhe thot:



"Andaj, ikni (prej dënimit) drejt (shpërblimit të) Allahut..."(Dharijat, 50)

Shuajbi alejhis-selam, i bëri thirrje popullit të vet:



"Kërkoni falje nga Zoti juaj e kthehuni me pendim tek Ai. Me të vërtetë, Zoti im është Mëshirëplotë dhe gjithë dashuri. (Hud, 90)

Dhe lutja jon e fundit është: I tërë falenderimi i takon Allahut, Zotit të botrave.


QKA PAS RAMAZANIT

Vëllëzer muslimanë !

O ju musliman, ishit në muajin e mirësisë dhe begatisë, agjëronit ditën, u faleshit natën dhe u afroheshit kah Zoti i juaj me adhurime të ndryshme duke e shpresuar shpërblimin e Tij dhe duke kërkuar mbrojtje prej dënimit të Tij.

Pastaj përfunduan këto ditë dhe e kaluat një periudhë të jetës së juaj e cila nuk do të kthehet më asnjëherë. Kështu janë ditët e jetës, periudha që do t'i kaloni ditë pas dite në rrugën e juaj për në ahiret. Ato e shkurtojnë jetën e juaj, u afrojnë kah exheli dhe ua ruajnë veprat të cilat i vepruat që të jepni llogari atë ditë kur të gjithë do të japin llogari:

Allahu, azze ue xhel, thotë:




“Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!”. Hixhër 99.

Muaji i Ramazanit ishte shans i juaj që t'i ktheheni pendimit dhe veprave të mira. Të edukoheni në veprimin e adhurimeve dhe largimin nga ndalesat dhe të bëheni të durueshëm dhe në fund të dilni fitimtar

Tani pasi që kaloi ky muaj mos iu ktheni mëkateve për arsye se Zoti i Ramazanit është edhe Zot i muajve të tjerë.

Prandaj përgjigjuni thirrjes së Allahut. E kush nuk i përgjigjet thirrjes së Allahut për të nuk ka siguri dhe mbrojtje dhe ai është në humbje të thellë.

Allahu, azze ue xhel, thotë:



"Ata, që u rëndohet peshorja (e punëve të mira), janë të shpëtuar.". Muminun 102.

Si është gjendja e atyre që në këtë muaj i nënshtroheshin adhurimeve dhe pas kalimit të tij u ndërrua gjendja e tyre. U pyetën disa prej selefit për këtë lloj njerëzish dhe thanë: "Sa njerëz të shëmtuar janë këta, nuk e njohin Allahun vetëm se në Ramazan."

Allahu, azze ue xhel, thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا أَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ وَلَا تُبْطِلُوا

أَعْمَلَكُمْ ٣٣

"O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut dhe bindjuni të Dërguarit dhe mos i çoni dëm veprat tuaja!". Muhamed 33.

Përcillet se një prej selefit para vdekjes qante dhe kur u pyet për shkakun tha: "Qaj për ato natë që nuk fala namaz në to dhe për ato ditë që nuk munda të agjëroj në to".

Këtë muaj duhet që ta përcjellim me kërkim të faljes dhe me shpresë dhe lutje për pranim të veprave.

Selefi i luteshin Allahut gjashtë muaj që të arrijnë muajin e Ramazanit, e kur e arrinin vepronin vepra të mira, pastaj luteshin gjashtë muaj që t'i pranojë Allahu veprat e tyre që i kanë bërë gjatë këtij muajit. Çdo kohë e tyre ishte Ramazan, ndërsa sot shumica e njerëzve Ramazanin e përcjellin duke bërë mëkate duke i lënë detyrimet dhe duke vepruar ndalesa.

O ju robër të Allahut, Allahu, azze ue xhel, na urdhëroi që ta përfundojmë muajin e Ramazanit me falënderim ndaj Allahut për plotësim e begatisë:

Allahu, azze ue xhel, thotë:

وَلْتُكَبِّرُوا اللَّهَ عَلَى مَا هَدَيْنَاكُمْ وَلَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ

"Dhe që ta madhëroni Allahun (në fund të agjërimit), për shkak se ju ka drejtuar në rrugë të drejtë e që ta falënderoni Atë." Bekare 185.

Ndërsa Pejgamberi, sal-IAllahu alejhi ue selem, na nxit që pasi ta kryejmë agjërimin e muajit Ramazan ta pasojmë atë me agjërim të gjashtë ditëve të muajit Sheual.

Imam Muslimi, Allahu e mëshiroftë, shënon në librin e tij një hadith prej Ebu Ejub el Ensarij, radijallahu anhu, i cili thotë se Pejgamberi, sal-IAllahu alejhi ue selem, ka thënë: "Kush e agjëron muajin e Ramazanit e pastaj ia bashkon edhe gjashtë të Sheualit është sikurse të kishte agjëruar tërë vitin".

Në përsëritjen e agjërit pas Ramazanit ka shumë dobi.

- Prej saj e kemi dobinë se agjërimi i këtyre gjashtë ditëve pas Ramazanit është si namazi nafle para dhe pas farzit.
- Prej dobive tjera është se përsëritja e agjërit pas Ramazanit është shenjë e pranimit të agjërit të muajit Ramazan. Allahu, azze ue xhel, kur ia pranon robit veprat e begaton pas saj me punë të mira, siç thonë disa se e mira shpërblehet me një të mirë pas saj.
- Prej dobive tjera është se agjërimi i muajit Ramazan i shlyen mëkatet e mëparshme dhe përsëritja e agjërit pas Bajramit është falënderim për ato begati me të cilat e begatoi Allahu robin e Tij gjatë muajit Ramazan.
- Prej begative poashtu është se përsëritja e agjërit pas Bajramit aludon në dëshirën e robit që të agjëron dhe se ai nuk është lodhur dhe mërzitur prej agjërit të Ramazanit.


Kush pretendon që t'i kthehet mëkateve pas Ramazanit agjërimi i tij është i refuzuar dhe dera e mëshirës e mbyllur.

Këto muaj dhe vite dhe ditë kalojnë shumë shpejtë, ndërsa Zoti i tyre është i Gjallë nuk vdes, Ai është gjithnjë prezent në çdo kohë dhe çdo vend me diturinë e Tij.

Po ju përkujtoj me një këshillë të ngjashme sikur Ebu Bekri, radijallahu anhu, që i këshilloi shokët e tij kur Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ue selem ndërroi jetë. Po ju them: **Kush e adhuroi Ramazanin, le ta dijë se Ramazani shkoi, e kush e ka adhuruar Allahun sinqerisht, le ta dijë se Allahu është me neve përgjithmonë, na sheh dhe dëgjon në çdo çast.**

Prandaj frikojuni Allahut dhe vazhdoni të veproni vepra të mira dhe të largoheni prej të shëmtuarës, se do të vjen një ditë kur do të dalin veprat në shesh:

Allahu, azze ue xhel, thotë:



“Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!”. Hixhër 99.

Pra nuk kalon asnjë ditë prej jetës së muslimanit vetëm se në të ka mundësi që të vepron vepra të mira të cilat e afrojnë kah Allahu. Prandaj o ju musliman, falënderoni Allahun për këto begati dhe shfrytëzoni ato në nënshtrime ndaj Allahut

Allahu na i pranoftë adhurimet tona dhe na shpërbleftë me xhenetin më të lartë, xhenetin firdeus, të qëndrojmë së bashku me pejgamberët, të singertit, shehidat dhe njerëzit më të mirë. AMIN !!!

O BESIMTARË! JU ËSHTË URDHËRU AGJËRIMI

Vëllezer Musliman !

Agjërimi i Ramazanit është shtyllë prej shtyllave të Islamit dhe farz (detyrim) prej farzeve të Allahut.

Këtë gjë e vërteton Kur'ani, Suneti dhe Ixhmau (konsensusi i shumicës së dijetarëve).

Allahu ka thënë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى
الَّذِينَ مِن قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ ﴿١٨٣﴾

"O ju që besuat, agjërimi (saum) u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm. (Bekare 183)

Allahu ka thënë:

فَمَنْ شَهِدَ مِنْكُمُ الشَّهْرَ فَلْيَصُمْهُ

"E kush e përjeton prej jush këtë muaj, le të agjërojë ...

(Bekare 185)

Pejgamberi salallahu alejhi ua selam thotë:

"Islami është ndërtuar mbi pesë shtylla, dhe prej tyre përmendi Agjërimin e Ramazanit" (Buhariu 8 dhe Muslimi 16).

Detyrimi i agjërit.

Vëllezer Musliman !

E ka detyrim të agjëroj muajin e Ramazanit çdo musliman i hyrë në moshë madhore dhe i aftë (ka mundësi dhe fuqi).

I vogli në moshë nuk e ka detyrim agjërimin, i pranohet agjërimi i tij nëse është që dallon gjërat. Ky agjërim është nafile për të.

Personi me të meta mendore, nuk e ka detyrë agjërimin, dhe nëse agjëron në këtë gjendje, nuk i pranohet agjërimi për shkak të mos prezencës së nijetit.

Nuk e ka detyrim agjërimin i sëmuri dhe udhëtari kur nuk mundet të agjëroj, por i plotësojnë ditët që kanë lënë kur të largohet shkakun që bëri të lejuar mos agjërimin (sëmundja, udhëtimi).

Allahu thotë:

وَمَنْ كَانَ مَرِيضًا أَوْ عَلَى سَفَرٍ فَعِدَّةٌ مِنْ أَيَّامٍ أُخَرَ

“...Nëse ndonjëri prej jush është i sëmure ose duke udhëtuar, le të agjëroj aq ditë sa i ka prishur në ditët e tjera më pas...” (Bekare 185).

Fillimi dhe mbarimi i ditës së agjërimit.

Vëllezer Musliman !

Allahu thotë:

ثُمَّ أَتَمُّوا الصِّيَامَ إِلَى اللَّيْلِ وَلَا تُبَشِّرُوهُنَّ وَأَنْتُمْ

Dhe hani e pini derisa të dallohet peri i bardhë (bardhësia) e agimit nga peri i zi (errësira e natës), pastaj plotësojeni agjërimin deri në mbrëmje” (Bekare 187).

Nga ajeti del qartë përcaktimi i fillimit dhe mbarimit të ditës së agjërimit.

Fillimi: Është nga lindja e sabahut të dytë.

Mbarimi: Dita e agjërimit mbaron me perëndimin e diellit.

Në dy librat e saktë nga Enesi transmetohet se ka thënë: tha Pejgamberi salallahu alejhi ua selam: **“Ngrihuni për syfyr, sepse në syfyr ka bereqet”** (Buhariu 1923 dhe Muslimi 1095).

Nga Sehl bin Sad Allahu qoftë i kënaqur prej tij transmetohet se Pejgamberi salallahu alejhi ua selam ka thënë: **“Do të vazhdojnë njerëzit të jenë në mirësi, derisa të shpejtojnë iftarin”** (Buhariu 1958 dhe Muslimi 1098).

Pejgamberi Salallahu alejhi ua selam duke transmetuar atë që i shpallet nga Zoti i tij thotë: **“Njerëzit më të dashur tek Unë janë ato që e shpejtojnë iftarin”**. (Ahmedi 2/237,329, Tirmidhiu 700, Ibnu Hibani 3507,3508)

Nga suneti është që ta çelësh iftarin me hurma të njoma, nëse nuk gjenden atëherë me hurma të thata, nëse dhe ato nuk gjenden atëherë me ujë.

Kjo duke u bazuar në thënien e Enesit Allahu qoftë i kënaqur prej tij i cili thotë: **"Pejgamberi salallahu alejhi ua salam e çelte agjërimin para se tu falte me hurma të buta, nëse nuk kishte hurma të buta, atëherë e çelte me hurma të thata, e nëse nuk kishte dhe as hurma të thata, atëherë me (hasua) tip hallve me ujë (hurma me miell dhe gjëra të tjera)"** (Ahmedi 3/164, ebi Daudi 2/306 dhe Tirmidhiu 696).

Është e pëlqyeshme që agjëruesi të lutet për çka të dëshiroj në iftarin e tij.

Pejgamberi salallahu alejhi ua salam thotë: **"Për agjëruesin gjatë iftarit ka dua që nuk kthehet"**. (Ibn Maxheh 1753, Hakimi 1/583, Bejhakiu 3/407'shejh Albani e ka bërë të dobët')(Të bërit dua para apo gjatë iftarit nuk është e saktë).

Nga duatë e transmetuara prej Pejgamberit salallahu alejhi ua salam janë: **"Allahume leke sumtu ua ala rzkkike efttertu- O Zot për Ty agjërova dhe me furnizimin Tënd hapa agjërimin).**(Ebu Daudi 2358).

Pejgamberi salallahu alejhi ua selam kur e cekte agjërimin thoshte: “U largua thatësia dhe u lagën damarët dhe është caktuar shpërblimi insha-Allah—Dhehebe dhema, uabteletil-uruku, ua thebete el-exhru insha-Allah’. (Transmetojnë Ebu Daudi 2357 dhe Hakimi 1/584).

ka thënë Allahu i Madhëruar:

لَقَدْ كَانَ لَكُمْ فِي رَسُولِ اللَّهِ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ لِّمَن كَانَ يَرْجُوا اللَّهَ وَالْيَوْمَ
الْآخِرَ وَذَكَرَ اللَّهَ كَثِيرًا



“Në të dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe dita e fundit dhe e përmend Allahun shumë” (Ahzab 21).

Gjërat që e prishin agjërimin.

Për agjërimin ka disa gjëra që e prishin dhe duhet për muslimanin ti njohë ato, në mënyrë që ti largohet atyre dhe të ruhet prej tyre, sepse ato e anulojnë agjërimin dhe e prishin atë.

Këto gjëra anuluese të agjëritit janë:

1. Marrëdhëniet seksuale. Kur agjëruesi bën marrëdhënie seksuale prishet agjërimi i tij, dhe e ka detyrë ta zëvendësojë atë ditë në të cilën ra në kontakt seksual. Përveç kësaj ka dhe detyrim kefare në cili është dëmshpërblim me lirim e një robi, nëse nuk gjen rob ose nuk ka mese ta liroj, atëherë ka detyrë të agjëroj dy muaj rresht pa shkëputje. Nëse nuk ka mundësi të agjëroj dy muaj për shkak të një arsye të saktë , të pranueshme nga feja. Atëherë e ka detyrë të ushqej 60 të varfër (miskina). Për çdo të varfër gjysmë Sau (njësi matëse, 1 sa≈2.7kg) nga ushqimi i zakonshëm që konsumohet në atë vend.

2. Ejakulimi (dalja e spermës). Për shkak të puthjes, prekjes, vazhdimi duke shikuar apo masturbimi. Nëse ndodh diçka e tillë, prishet agjërimi, në këtë rast është detyrë kompensimi dhe jo kefare (dëmshpërblim) sepse ajo është e veçantë vetëm në raste marrëdhëniesh seksuale. Ai që është në gjumë dhe bëhet xhunub, nuk ka ndonjë problem dhe agjërimi i tij është i sakte, sepse kjo gjë ndodhi pa zgjedhjen dhe dëshirën e tij. Por që duhet dhe e ka detyrë që të lahet (të marri gusul).

3. Ngrënia dhe pirja qëllimisht me dëshirë.

Por kush han ose pi me harresë, kjo nuk ndikon në agjërimin e tij.

Në një hadith thuhet: “Kush ha ose pi me haresë, le ta plotësoj (vazhdoj) agjërimin, sepse Allahu e ka ushqyer dhe i ka dhënë me pi” (Buhariu 1933 dhe Muslimi 1155).

Prej gjërave të tjera që e prishin agjërimin janë.

Kalimi i ujit dhe diçka të ngjashme me të në bark nga hunda, ilaçe që merren nga hunda (seutt). Marrja e ilaçeve nëpërmjet venave, injeksionet me gjak (transfuzionet). Të gjitha këto veprime e prishin agjërimin sepse janë ushqyese për organizmin.

Gjithashtu dhe injeksionet që kanë ndikim ushqyes (serumet) e prishin agjërimin sepse luajnë rolin e ushqimit, gjë e cila e prish agjërimin.

Ndërsa për injeksionet që nuk kanë efekt ushqyes është më mirë për agjërulesin të mos i marri ato, që të ruaj agjërimin e tij.

Kjo duke u bazuar në fjalën e Pejgamberit salallahu alejhi ua selam **“Lëre atë që të duket e dyshimtë dhe bëj atë që s’është e dyshimtë”**. (Ibn Khuzejme 2348, Tirmidhiu 2518, Nesaiu 5220, Hakimi 2/13, Ahmed 1/200)

Prej prishësve të tjerë të agjërimit është dhe vjellja - nxjerrja nga stomaku e ushqimit apo pijes nëpërmjet gojës qëllimisht.

Nëse vjellja është jo e qëllimshme, ushqimi del jo me dëshirën e personit, atëherë agjërimi nuk priset, për fjalën e Pejgamberit salallahu alejhi ua selam **“Kush vjell pa dëshirën e vet, nuk ka kompensim (kada), ndërsa kush vjell me qëllim atëherë ta kompensoj atë ditë”**. (Ahmed 2/498, Tirmidhiu 720, Ebu Daud 2380, Ibn Maxheh 1676, Hakim 1/598)

Nuk duhet që ta teproj gjatë abdesit me futjen e ujit në gojë, duke bërë gargara. Apo futjen e ujit në hundë sepse ndoshta uji mund të kalojë në bark.

Pejgamberi salallahu alejhi ua selam thotë: **“Fute ujin thellë në hundë, përveç nëse je duke agjëruar”**. (Tirmidhiu 788, Ebu Daud 142, Nesaiu 98, Ibn Maxheh 407, Ibn Khuzejme 150, Ibn Hibani 1054)

Për muslimanin është detyrë që të ketë frikë dhe respekt ndaj Allahut, të kuptoj dhe të përfytyroj madhësitë, fuqinë mbikëqyrjen e Tij në çdo vend dhe në çdo gjendje. Atëherë le të ruaj dhe të kujdeset për agjërimin e tij nga ato gjëra që e prishin dhe ja ulin vlerën atij, në mënyrë që agjërimi i tij të jetë i saktë.

Për agjëruenin duhet që të preokupohet me përmendjen e Allahut dhe leximin e Kur'anit, të shumoj në veprimin e nafileve (veprave të mira vullnetare).

Sepse të parët tanë të mirë (selefët) kur agjëronin, uleshin nëpër xhamia dhe thoshin: **"Ruajmë agjërimin tonë dhe nuk marrim nëpër gojë asnjë"**.

Pejgamberi salallahu alejhi ua selam thoshte: **"Kush nuk lë fjalët e ulëta, të rënda dhe punën me to, Allahu nuk ka nevojë që ai të lërë ushqimin dhe pijen e tij"**. (Buhariu 6057)

Transmetohet nga ebu Hurejra radijallahu anhu, se Pejgamberi salallahu alejhi ua selam ka thënë: **"Agjërueni në adhurim derisa të mos i shajë muslimanët apo ti dëmtoj ato"**. (Ibnul Xheuzi në llet 887, Ibn Ebi Shejbe 2/272, Abderrazak 7895)

Nga Enesi radijallahu anhu transmetohet: “Nuk agjëron kush rri në hije dhe ha mishin e njerëzve”. (Ibn Ebi Shejbe 2/272, Henad 1206)

I Moshuari dhe Smundja

Allahu thotë:

لَا يُكَلِّفُ اللَّهُ نَفْسًا إِلَّا وُسْعَهَا

“Allahu nuk e ngarkon askënd përtej fuqisë që ka...” (Bekare 286)

Allahu thotë:

وَعَلَى الَّذِينَ يُطِيقُونَهُ فِدْيَةٌ طَعَامُ مِسْكِينٍ

“Ata që kanë vështirësi për të agjëruar, duhet të ushqejnë si shpagim nga një të varfër për çdo ditë agjërimi”. (Bekare 184).

Ibn Abas radijallahu anhumu ka thënë: "(dhënia e ushqimit) është për burrin ose gruan me pleqëri të thellë të cilët nuk kanë mundësi të agjërojnë le të ushqejnë për çdo ditë agjërimi një të varfër" (Buhariu 4505).

Po ashtu thotë:

"... kush është i sëmure (gjatë Ramazani), apo është në udhëtim (le të agjëroj më vonë) aq ditë sa nuk i ka agjëruar" (Bekare 184).

I sëmuri të cilin e dëmton agjërimi, e prish agjërimin, dhe udhëtari të cilit i lejohet të shkurtoj namazin (kjo është sunet). Kjo duke u mbështetur në fjalën e Allahut të Madhëruar mbi të drejtën e tyre :

فَعِدَّةٌ مِّنْ أَيَّامٍ أُخَرَ

"...të marrin për zëvendësim ditë të tjera..." që do me thënë: le të mos agjërojnë dhe të agjërojnë aq ditë më vonë.

Allahu thotë:

يُرِيدُ اللَّهُ بِكُمْ الْيُسْرَ وَلَا يُرِيدُ بِكُمْ الْعُسْرَ

"... Allahu dëshiron që t'jua lehtësoj dhe jo që t'jua vështirësoj"
(Bekare 185).

Pejgamberi salallahu alejhi ua selam nëse i duhej të zgjidhte mes dy çështjeve zgjidhte më të lehtë. Dhe në dy librat e sakta (Buhari dhe Muslimi)

Pejgamberi salallahu alejhi ua selam thotë: **"Nuk është mirësi agjërimi në udhëtim"**. (Buhariu 1946, Muslimi 1115)

Ibn Kajim ka thënë:

"Shkaqet e prishjes së agjërit janë 4: Udhëtimi, sëmundja, menstruacionet dhe frika nga vdekja për atë që është në këtë gjendje, ka frikë se agjërimi e dëmton atë si: Ajo që i jep gji fëmijës ose është shtatzënë, e njëjtë është dhe çështja e atij që është duke u mbytur" (bedaiul feuaid 4/846).

Nijeti (qëllimi).

Është detyrë për muslimanin: Që të qartësoj (përcaktoj) nijetin e agjërimit farz që në **darkë**, që ta dalloj nga agjërimet e tjera. Si agjërimi i Ramazanit nga agjërimi i kefares (dëm shpërblim) dhe nga agjërimi i zotimit.

Pra duhet ta dijë dhe të besoj se po agjëron nga Ramazani ose plotësimin e tij (nëse ka lënë ditë pa agjëruar (kada), ose po agjëron për zotimin ose për dëmshpërblim (kefare).

Pejgamberi salallahu alejhi ua selam ka thënë: **“Vërtet veprat vlerësohen sipas nijetit, dhe çdo njeriu i takon ajo që ka pasur për qëllim...”**(Buhariu 1, Muslimi 1907).

Nga Aishja radijallahu anha transmetohet. **“Kush nuk bën nijet për agjërim para agimit, nuk ka agjërim për të”**. (Ebu Daudi 2/171, Ahmed 6/287, Nesai 2640).

Pra duhet të bëhet nijeti për agjërimin e detyruar që natën. Kush bën nijet për agjërim ditën, si për shembull dikush gdhihet pasi ka zbardhur dhe nuk ka ngrënë gjë, pastaj bën nijet për agjërim, kjo nuk lejohet vetëm se në agjërimin vullnetar.

Ndërsa agjërimi i detyruar: Nuk fillon nijeti që nga dreka, sepse e gjithë dita është detyrim të agjërohet dhe nijeti nuk lidhet me të shkuarën.

Për sa i përket agjërimit vullnetar lejohet të fillohet nijeti dhe ditën. Për shkak të hadithit të Aishes radijallahu anha:

“U fut te unë peygamberi salallahu alejhi ua selam një ditë dhe tha: A ka diçka për të ngrënë? I thash jo! Tha: Atëherë po agjëroj” (Muslimi 2708).

Lusim Allahun të na japi sukses në fjalët dhe veprat tonë dhe na bëjë prej atyre që e shohin të vërtetën si të vërtetë dhe ta pasojmë atë dhe të kotën si të kotë dhe të na largojë nga ajo, Amin.

NË FUND KËRKO FALJE ALLAHUT

Vëllezër! mos harroni se mësimi merret nga fundi i veprës e jo nga fillimi dhe veprat llogariten ashtu siç përfundojnë në fund. Fundi është Istigfar-kërkim të faljes!

Këtë gjë e kishte kuptuar mirë Halifeja i drejte Omer b. Abdul Aziz, i cili në fundin e Ramazanit iu kishte shkruar letër të gjithë mëkëmbësve të tij që Ramazanin ta përfundonin me kërkim të faljes së mëkateve-istigfar.

Në shkresën e tij, shkruante kjo: Dhe u Thonte:

“Thuani siç ka thënë babai juaj Ademi:

قَالَ رَبَّنَا ظَلَمْنَا أَنْفُسَنَا وَإِنْ لَمْ تَغْفِرْ لَنَا وَتَرْحَمْنَا لَنَكُونَنَّ مِنَ

الْخَسِرِينَ ﴿٢٣﴾

Zoti ynë, ne i bëmë të padrejtë (dëmtuam) vetvetes sonë, në qoftë se nuk na falë dhe nuk na mëshiron, ne me siguri do të jemi prej të shkatërruarve!”. (A’raf, 23)

Thuani siç ka thënë Nuhu, alejhi' selam:

وَالَا تَغْفِرْ لِي وَتَرْحَمْنِي أَكُنْ مِنَ الْخَسِرِينَ ﴿٤٧﴾

...e në qoftë se nuk më fal mua dhe nuk më mëshiron Ti, do të jem i humbur!". (Hud, 47)

Thuani siç ka thënë Musai, alejhi's selam:

قَالَ رَبِّ إِنِّي ظَلَمْتُ نَفْسِي فَاغْفِرْ لِي فَغَفَر لَهُ إِنَّهُ هُوَ الْغَفُورُ
الرَّحِيمُ ﴿١٦﴾

"Zoti im, unë e ngarkova veten e Ti më fal mua!" Dhe Ai ia fali, se Ai është që fal shumë, është mëshirues". (Kasas, 16)

Thuani siç ka thënë Junusi, alejhi's selam:

لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ سُبْحَانَكَ إِنِّي كُنْتُ مِنَ الظَّالِمِينَ ﴿٨٧﴾

Nuk ka Zot pos Teje. Ti je i pastër, nuk ke të meta. Unë i bëra padrejt vetes!". (Enbija, 87)

Llukmani e këshillonte të birin:

O biri im! Beja shprehi vetes istigfarin ngase Allahu ka caktuar kohë, në të cilat nuk e refuzon lutësin”.

Allahu subhanehu we te A'la e thrret Pejgamberin Sal-Allahu alehji we sel-lem duke i thën:

فَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ وَأَسْتَغْفِرْهُ إِنَّهُ كَانَ تَوَّابًا ﴿٣﴾

“Ti pra, lartësoje Zotin tënd duke falenderuar dhe kërko nga Ai falje. Ai vërtet pranon shumë pendimin, është Mëshirues i madh.”

(En Nasr: 3)

Allahu Subhanehu we te A'la na thrret: Duke thën !

Allahu i Lartësuar thotë:

فَقُلْتُ اسْتَغْفِرُوا رَبَّكُمْ إِنَّهُ كَانَ غَفَّارًا ﴿١٠﴾

“Unë u thashë: “Kërkoni falje Zotit tuaj, se ai vërtet falë shumë” (Nuh: 10)

Pejgamberin Sal-Allahu alehji we sel-lem na ka urdhëruar që gjithmonë dhe përgjithmonë të bëjmë istigfar ku thotë: "O ju njerëz kërkon falje dhe pendohuni te Allahu se unë kërkoj falje te Allahu dhe pendohem njëqindë herë në ditë".

Pejgamberin Sal-Allahu alehji we sel-lem ka thënë: "Kush e shpreshton istigfarin Allahu i Lartësuar do të ia lehtësojë brengat dhe do ta furnizojë nga nuk e mendon".

Ebu Minhali ka thënë: "Robi nuk ka bërë kujdes më të mirë në varrin e tij se istigfari".

Hasan El Basriu ka thënë: "Shpreshtojeni istigfrin në shtëpitë e juaja, në rrugë, tregje, mexhlise, sepse ju nuk e dini se kur zbret mëshira".

Prej Vlerav të istigfarit:

اللَّهُمَّ أَنْتَ رَبِّي لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ
خَلَقْتَنِي وَأَنَا عَبْدُكَ ، وَأَنَا عَلَى عَهْدِكَ
وَوَعْدِكَ مَا اسْتَطَعْتُ أَعُوذُ بِكَ مِنْ
شَرِّ مَا صَنَعْتُ ، أَبُوءُ لَكَ بِنِعْمَتِكَ
عَلَيَّ ، وَأَبُوءُ بِذَنْبِي ، فَاعْفِرْ لِي فَإِنَّهُ
لَا يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلَّا أَنْتَ .

(O Allah, Ti je Zoti im, nuk ka të adhurar përveç Teje. Ti më ke krijuar dhe unë jam robi yt, do të qëndroj besnik në marrëveshjen dhe premtimin që e kam bërë ndaj Teje sa të kem mundësi. Kërkoj mbrojtjen Tënde nga e keqja që e kam vepruar. Unë jam mirënjohës për dhuntitë Tua, i pranoj mëkatet e mia, të lutem më fal, sepse nuk i fal mëkatet askush tjetër përveç Teje)

اللَّهُمَّ إِنِّي ظَلَمْتُ نَفْسِي ظُلْمًا كَثِيرًا
وَلَا يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلَّا أَنْتَ فَاعْفِرْ لِي
مَغْفِرَةً مِنْ عِنْدِكَ وَارْحَمْنِي، إِنَّكَ
أَنْتَ الْغَفُورُ الرَّحِيمُ.

"(O Zot unë vetes i kam shkaktur shumë padrejtësi, vetëm Ti je që falë mëkate, andaj më fal dhe më mëshiro, ngase ti je Ai që falë dhe që është i mëshirshëm)"

أَسْتَغْفِرُ اللَّهَ الَّذِي لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ
الْقَيُّومُ وَأَتُوبُ إِلَيْهِ.

(I lutem Allahut të Madhërishëm, i Cili nuk ka Zot tjetër pos Tij, është i Gjallë dhe i Përjetshëm, që të m'ï falë mëkatet dhe të ma pranojë pendimin).

Allahu Subhanehu we te A'la na thrret:

﴿قُلْ يَاعِبَادِيَ الَّذِينَ أَسْرَفُوا عَلَىٰ أَنفُسِهِمْ لَا تَقْنَطُوا مِن رَّحْمَةِ اللَّهِ إِنَّ اللَّهَ يَغْفِرُ الذُّنُوبَ جَمِيعًا إِنَّهُ هُوَ الْغَفُورُ الرَّحِيمُ﴾
٥٣

“Thuaj: O robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj! Mos e humbi shpresën në mëshirën e Allahut. Allahu i fal të gjithë gabimet. Ai është shumë Falës dhe shumë Mëshirues.”(Zumer: 53)

Së fundi Falënderimi i takon Allahut Subhanehu we te A'la, Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi Pejgamberin Sal-IAllahu alejhi we sel-lem mbi familjen e tij shoktët e tij dhe mbi të gjith ata që ndjekun dhe pasojn rrugën e tij. Amin

Dhe kërkojmë falje o Zoti ynë, pendohemi tek Ti prej mangësisë, pakujdesisë, harresës dhe gabimit, Amin.

DITË TË CAKTUARA

KOHA DHE SHFRYTËZIMI I SAJ NË RAMAZAN

Vëllezer Musliman !!!

Ramazani është muaj i begative dhe mirësive të shumta. Është muaji që besimtarit i dhuron shanse dhe mundësi të shumta. Por, Ramazani është vetëm një muaj. Është siç thotë Allahu i Madhëruar:

أَيَّامًا مَّعْدُودَاتٍ

Ditë të caktuara..." (el-Bekare: 184)

Kështu që këto ditë, e bashkë me to shanset dhe mundësitë, kalojnë shpejt. Kjo ngase koha është bile edhe më e shtrenjtë se ari. E dini se thuhet "koha është sikur ari" por ari nëse humbet mund të kompensohet ndërsa koha kurrë. Mbase këtu mund të qëndrojë arsyeja pse Allahu betohet në kohë.

Thot Allahu subhanehu we te A'la

وَالْعَصْرِ ١

إِنَّ الْإِنْسَانَ لِفِي خُسْرٍ ٢


إِلَّا الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَتَوَّصَوْا بِالْحَقِّ وَتَوَّصَوْا

بِالصَّبْرِ ٣

Pasha kohën!. Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t'i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm." (el-Asr: 1-3.)

Se koha e humbur nuk mund të kthehet dhe se ajo është dëshpërimi më i madh që kap njeriun vërteton Kur'ani në një tjetër vend, apo më konkretisht me rastin e vdekjes.

Thot: Allahu Subhanehu we te Ala



E kur ndonjërit prej tyre i vjen vdekja, ai thotë: "O Zoti im, më kthe,
(Mu'minune :99).

TEUBEJA NË RAMAZAN

Vëllezer Musliman !

Gjëja më e keqe që ka mundësi ta godas njeriun është dëshprimi dhe humbja e shpresës në faljen dhe mëshirën e Allahut.

Nuk ka dyshim se Allahu ia pranon pendimin dhe ua falë mëkatet e veçanërisht në muajin e bekuar të Ramazanit. Andaj Ramazani është muaj i faljes,dhe njeriu le t'i kthehet Allahut sinqerisht me pendim në këtë muaj të faljes.

Allahu i Madhëruar i thërret robërit e Tij për pendim, duke thënë:

Thot Allahu Subhanehu we te A'la

﴿قُلْ يَاعِبَادِيَ الَّذِينَ أَسْرَفُوا عَلَىٰ أَنفُسِهِمْ لَا تَقْنَطُوا مِن رَّحْمَةِ اللَّهِ إِنَّ اللَّهَ يَغْفِرُ الذُّنُوبَ جَمِيعًا إِنَّهُ هُوَ الْغَفُورُ الرَّحِيمُ﴾
٥٣

Thuaj: "O robërit e mi, që i keni bërë keq vetvetes, mos ehumbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i falë të gjitha mëkatet. Ai, me të vërtetë, është falës dhe përdëllimtar." (Zumer: 53).

Po ashtu thot:

﴿أَفَلَا يَتُوبُونَ إِلَى اللَّهِ وَيَسْتَغْفِرُونَهُ، وَاللَّهُ غَفُورٌ
رَّحِيمٌ﴾
٧٤

"E pse të mos pendohen dhe të kërkojnë te Allahu falje, kur Allahu dihet se falë shumë, është mëshirues?". (El-Maide: 74).


Ebu Hurejre radijAllahu anhu tregon se Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem duke hipur në minber tha: "Amin, amin, amin. I thanë: o i Dërguar i Allahut duke hypur në minber të dëgjuam duke thënë: amin, amin, amin. Tha: "Më erdhi Xhibrili [alejhis-selam] e më tha: cili e takon Ramazanin e nuk i falen mëkatet e largoftë Allahu nga Mëshira e Tij, thuaj amin, e unë thash: amin". (Ahmedi, sahih).

Andaj vëllezer të përulur, e të penduar, duke qarë e të lutemi : O Zot i gjithësisë, unë u pendova më fal Amin !!!

Vëllazer të dashur!


Nëse nuk të falen mëkatet në këtë muaj, nëse në këtë muaj nuk të lotojnë sytë, nëse zemra jote para Zotit tënd nuk përulet në këtë muaj, vallë kur do të ndodh kjo gjë?!

Nëse nuk Pendohemi vëllezer thot Allahu subhanehu we te A'la



"E ata që nuk pendohen, janë mizorë. (Huxhurat, 11)

Andaj vëllezer Allahu subhanehu we te A'la na fton dhe thot:



"Andaj, ikni (prej dënimit) drejt (shpërblimit të) Allahut..."(Dharijat, 50)

Thot: Pejgamberi Sal-Allahu alejhi we sel-lem

“Allahu e shtrin Dorën gjatë natës që të pendohet ai që ka bërë gabime gjatë ditës dhe e shtrinë Dorën gjatë ditës që të pendohet ai që ka bërë mëkate gjatë natës. Kështu vazhdon deri sa të del dielli nga perëndimi i tij”. (Muslimi).

A nuk është e madhe kjo bujari që të pendohemi!

I lartësuar qoftë Allahu sa i mëshirshëm, sa i butë dhe sa Bujar që është!

VLERA E DHJETË DITËVE TË FUNDIT TË RAMAZANIT

Të nderuar vëllezërit e mi:

Tashmë kemi për të hyrë në dhjetëditshin e fundit të këtij muaji të bekuar, këto netë të fundit kan veçori dhe vlera të mëdha. I dërguari i Allahut e angazhonte veten e tij në këto netë të fundit në kryerjen e veprave të mira, e shtonte ibadetit më shumë se në netët tjera.

Në Sahihun e Buhariut dhe Muslimit, nga Aisheja, radijAllahu anha, tregohet se ka thënë:

” Kur hynte dhjetëditëshi i fundit, Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, shtrëngonte izarin, falte namaz gjithë natën(e kalonte natën në adhurim) dhe për këtë zgjonte edhe pjesëtarët e familjes.”

Nuk duhet të anashkalojë muslimani edhe familjën e tij nga angazhimi i tyre për ibadet, duke i këshilluar që edhe ata të kalojnë pjesën e madhe të kohës në ibadet, ngase një gjë të tillë e vepronte edhe i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem.

Këto dhjetë netë të fundit është edhe nata e kadrit, e cila është më me vlerë se njëmijë muaj. ibadeti në të cilën është më i mirë sesa ibadeti i 1000 muajve, (83) vite e (4) kater muaj... Ajo është Nata e Kadrit.

Andaj Allahu subhanehu we te A'la thot:

لَيْلَةُ الْقَدْرِ خَيْرٌ مِّنْ أَلْفِ شَهْرٍ
نَزَّلُ الْمَلَائِكَةُ وَالرُّوحُ فِيهَا بِإِذْنِ رَبِّهِمْ مِّنْ كُلِّ أَمْرٍ
سَلَامٌ هِيَ حَتَّى مَطْلَعِ الْفَجْرِ

"Nata e Kadrit është më e rëndësishme se një mijë muaj! Me lejen e Zotit të tyre në (atë natë) të zbresin engjëj dhe shpirti (Xhibrili) për secilën çështje. Ajo (që përcakton Zoti) është paqe deri në agim të mëngjesit. El-Kader, 1-5.

Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem. Thot:

Ai që fal namazin e natës Natën e Kadrit me besim dhe shpresë për shpërblim (nga Allahu), i falen gjynahet që ka bërë."

Mutefekun alejhi(Buhariu dhe Muslimi).

Muslimani në këtë natë duhet t'i shpeshtojë edhe lutjet e tij.

Transmetohet se Aisheja, radijAllahu anha, ka thënë:

Thash: O i dërguar i Allahut, nëse e arrijë natën e kadrit, çfar duhet tëthem(lutem)?

اللهم إنك عفو تحب العفو فعف عني

Thuaj: O Allahu im, Ti je Falës, e do faljen, më falë mua." (Tirmidhiu).

E lus Allahun, azze ue xhel, që në këtë muaj të na falë dhe mëshirojë, adhurimet të na i shtojë, duatë dhe lutjet të na i pranojë, neve të gjithëve dhe prindërit tanë dhe familjet e tona prej Zjarri të na liron.

ADHURIMET DUHET TË VAZHDOJN

O ju musliman, frikojuni Allahut në vazhdimësi me adhurime dhe me largim nga e ndaluara. Shpëtoi ai që u kap për devotshmërinë në dynja dhe ahiret. Dhe humbi ai që e pasoi epshin dhe të ligën.

Allahu i Madhëruar thotë:

وَمَنْ يَشْكُرْ فَإِنَّمَا يَشْكُرُ لِنَفْسِهِ ۖ وَمَنْ كَفَرَ فَإِنَّ اللَّهَ غَنِيٌّ حَمِيدٌ ﴿١٢﴾

“Kush është falënderues, e bën për të mirën e vet dhe, kush mohon, ta dijë se vërtet Allahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Denjë për lavdërim”.
Llokman 12.

Kurse me një hadith Kudsi, Allahu i Madhëruar thotë: “O robërit e mi, këto janë veprat tuaja, të cilat tek Unë janë të ruajtura dhe të llogaritura, e për to Unë do t’ju shpërblej. Pra, ai që gjen mirë le ta falënderojë Allahun, ndërsa ai që gjen keq le të mos e fajësojë askë pos vetveten!”.

Allahu i Madhëruar thotë:

رَبُّ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا فَاعْبُدْهُ وَاصْطَبِرْ لِعِبَادَتِهِ ۚ

“Ai është Zoti i qiejve, i Tokës dhe i gjithçkaje që është midis tyre, prandaj, vetëm Atë adhuroje dhe bëhu i qëndrueshëm në adhurimin ndaj Atij!”. Merjem 65

O ju musliman, a nuk e dini se gjendja më e mirë e një muslimani është kur ai adhurimin e përcjelle me adhurim tjetër, dhe kur të mirat i përcjell me të mira tjera dhe largohet nga të ligat!?

Allahu i Madhëruar thotë:

وَالَّذِينَ أَهْتَدَوْا زَادَهُمْ هُدًى وَءَانَّهُمْ تَقْوَاهُمْ

“Sa për ata që ndjekin rrugën e drejtë, Ai ua shton udhëzimin dhe u jep devotshmëri e vetëpërmbytje”. Muhamed 17.

Mrekullia më madhe është që Allahu t'i dhuron robit përqendrim në fe gjatë tanë jetës së tij. Kjo është fitorja e plotë dhe lumturia e përsosur.

Allahu i Madhëruar thotë:

إِنَّ الَّذِينَ قَالُوا رَبُّنَا اللَّهُ ثُمَّ اسْتَقَمُوا فَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ
يَحْزَنُونَ ﴿١٣﴾

“Pa dyshim, ata që thonë: “Zoti ynë është Allahu!” dhe pastaj qëndrojnë në rrugën e drejtë, nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar e as për t’u dëshpëruar (kur t’u vijë vdekja).

أُولَئِكَ أَصْحَابُ الْجَنَّةِ خَالِدِينَ فِيهَا جَزَاءُ بِمَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿١٤﴾

Ata do të jenë banorë të Xhenetit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë, si shpërblim për atë që kanë punuar”. Ehkaf 13-14.

Sufjan ibën Abdullah, RadijAllahu anhu, thotë se i thash Pejgamberit sal-Allahu alejhi ue selem, tregoma një fjalë në Islam që mos ta pyes pas teje për të askënd?! lu përgjigj: “Thuaj besova në Allahun dhe pastaj përqendrohu në të”.

Allahu është Ai që adhurohet në çdo vend dhe kohë dhe Ai është që detyrohemi t’i nënshtrohemi.

Allahu i Madhëruar thotë:

وَأَعْبُدْ رَبَّكَ حَتَّى يَأْتِيَكَ الْيَقِينُ ﴿٩٩﴾

“Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!”. Hixhër 99.

Komentuesit e Kuranit kur e komentojnë këtë ajet thonë: Adhurojeni Allahun gjithmonë deri sa t’ju vjen vdekja.

Hasan el Basriu, Allahu e mëshiroftë, thotë: “Për besimtarin nuk ka kohë e cila përfundon, derisa t’i vjen vdekja”.

Para çdo gjëje kërko nga Allahu ndihmë sepse Ai të ka udhëzuar dhe kërko nga Ai që të të forcojë ne fenë e Tij, ashtu siç është lutur Resulullahu alejhi salatu ue selam, kurse ne e dimë shumë mirë se sa më shumë se Pejgamberi, sal-IAllahu alejhi ue selem, kemi nevojë për këtë lutje! Ngase Allahu i Madhërishëm i ka lavdëruar në Kuran ata të cilët luten dhe thonë:

رَبَّنَا لَا تُزِغْ قُلُوبَنَا بَعْدَ إِذْ هَدَيْتَنَا وَهَبْ لَنَا مِنْ لَدُنْكَ رَحْمَةً إِنَّكَ أَنْتَ

الْوَهَّابُ

“Zoti ynë mos na i lako zemrat tona pasi na i drejtove, na dhuro mëshirën Tënde, pasi që vetëm Ti je Dhuruesi më i madh.” (Ali imran:8)

Madje vetë Pejgamberi, sal-IAllahu alejhi ue selem, për këtë është lutur duke thënë: “O Ti që i rrotullon zemrat, ma përforco zemrën në fenë Tënde”. (Transmeton Tirmidhiu)

kurse në një version tjetër: "O Ti që i kthen zemrat, ma kthe zemrën time në ibadetin për Ty. (Transmeton Muslimi)

Prandaj o ju musliman falënderoni Allahun për këto begati dhe shfrytëzoni ato në nënshtrime ndaj Allahut .

VLERA E DHJETË DITËVE TË FUNDIT TË RAMAZANIT

Të nderuar vëllezërit e mi:

Tashmë kemi hyrë në dhjetëditshin e fundit të këtij muaji të bekuar, këto netë të fundit ngërthejnë në veten e tyre veçori dhe vlera të mëdha.

I dërguari i Allahut e angazhonte veten e tij në këto netë të fundit në kryerjen e veprave të mira, e shtonte inteзитetin e ibadetit më shumë se në netët tjera.

Në sahihun e Muslimit, nga Aisheja, radijAllahu anha, tregon se peygamberi alejhi salam, jepte mund dhe e angazhonte veten e tij në dhjetshin e fundit më shumë se netët tjera.

Në Sahihun e Buhariut dhe Muslimit, nga Aisheja, radijAllahu anha, tregohet se ka thënë:

“ Kur hynte dhjetëditëshi i fundit, Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, shtrëngonte izarin, falte namaz gjithë natën(e kalonte natën në adhurim) dhe për këtë zgjonte edhe pjesëtarët e familjes.”

Në musnedin e Imam Ahmedit, transmetohet se Aisheja, radijAllahu anha,ka,thënë:

“ I dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, njëzetëditëshin e parë të Ramazanit e përizente gjumin me namaz(falej natën por edhe flente një pjesë të saj).Ndërsa, në dhjetëditëshin e fundit e shtrëngonte izarin dhe e kalonte tërë natën në namaz.”

Këto hadithe na mësojnë se këto dhjetë netë të fundit kanë vlera të mëdha, dhe muslimani duhet të angazhohet më shumë se në netët tjera të Ramazanit.

Nuk duhet të anashkalojë muslimani edhe familjën e tij nga angazhimi i tyre për ibadet, duke i këshilluar që edhe ata të kalojnë pjesën e madhe të kohës në ibadet, ngase një gjë të tillë e vepronte edhe i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem.

Këto dhjetë netë të fundit është edhe nata e kadrit, e cila është më me vlerë se njëmijë muaj.

Kush e kalon këtë natë në adhurim me bindje dhe shpresë tek Allahu, atij do t’i falen mëkatet e vepruara më parë.

I dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ka thënë:

" Kush falet(e kalon natën në adhurim) në natën e kadrut me bindje(iman) dhe shpresë(duke llogarit në shpërblimin e Allahut) do t'i falen mëkatet e vepruara më parë(të kaluarat).

Mutefekun alejhi(Buhariu dhe Muslimi).

" Nate e kadrut është më me vlerë sesa njëmijë muaj." (El Kadr: 3).

Përpos këtyre vlerave që u cekën më lartë, në këtë natë zbresin nga qielli edhe krijesat e Allahut, melaiket.

" Engjëjt dhe Xhebraili, me lejen e Zotit të tyre, zbresin në të, për të zbatuar (të gjitha) urdhërat e Zotit." (El Kadr: 4).

Muslimani në këtë natë duhet t'i shpreshtojë edhe lutjet e tij.

Transmetohet se Aisheja, radijAllahu anha, ka thënë:

Thash: O i dërguar i Allahut, nëse e arrijë natën e kadrut, çfarë duhet të them(lutem)? Thuaj: **O Allahu im, Ti je Falës, e do faljen, më falë mua.**" (Tirmidhiu).

Gjithashtu, ky dhjetëditësh i fundit, karakterizohet edhe me hyrjen në Itikaf:

Në sahihun e Buhariut dhe Muslimit, transmetohet se Ibën Omeri, radijAllahu anhumâ, ka thënë: " I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, hynte në Itikaf në dhjetëditëshin e fundit të Ramazanit."

Ky hadithë, është argument për legjimitetin e Itikafit në Islam.

Itikaf, dmth:

" Izolimi në xhami me qëllim afrimi tek Allahu."

Itikafi nuk është obligim, por është adhurim vullnetarë(nafie).

Ibën Kajimi, rahimehullah, e sqaron arsyen e Itikafit dhe qëllimin e tij në Islam: " Itikafi u bë legjitim në sheriatin islam që zemra e njeriut të shkëputet nga dunjaja e krijesat dhe t'i drejtohet vetëm Allahut e ta lidh zemrën e tij me Allahun.

Ta mbush zemrën me adhurim dhe dashuri ndaj Krijuesit të Tij.

Ta ndjejë dhe shijoj kënaqësinë e adhurimit të cilin e bënë gjatë Itikafit, njëjerit ky është një nga qëllimet më madhore të Itikafit."

Shejh Muhamed Ibën Salih el Uthejmin, rahimehullah.



Përgaditi: Ismet Hyseni